



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të OJQ-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore, sipas Thirrjes publike datë 18.03.2026, merr:

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË OJQ-ve PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE RINORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-ve, për realizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike, datë 18.03.2026 dhe Rekomandimit të Komisionit vlerësues datë 01.06.2026, ndahen mjete financiare në shumë **26,000 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore dhe rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/04-0031739/26
Podujevë, date: 01.06.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 3 paragrafi 3, dhe nenin 27 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01- 016/01-0030667/22 datë 29.04.2022, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01- 020/01-0050862/18, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-401/01-0062888/25 datë 29.09.2025 për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2027- 2028, sipas Thirrjes publike nr.prot.09-400/04-0016391/26 datë 23.03.2026 për financimin e projekt propozimeve individuale për organizmin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, në Rekomandim të Komisionit ad-hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merr,

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINACIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE INDIVIDUALE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE KULTURORE DHE ARTISTIKE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financimin e projekt propozimeve individuale për organizmin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës sipas Thirrjes publike nr.prot.09-400/04-0016391/26 datë 23.03.2026, lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 20,000.00€.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për kushtet dhe mënyrën e realizmit të aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidh kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 datë 29.04.2022.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas Listës përfundimtare të përfituesve pjesë përbërëse e këtij Vendimi nuk e tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 4

Zbatimin e këtij Vendimi e bëjnë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-400/01-0031927/26
Podujevë, datë 02.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të ojq-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike datë 24.03.2026, merr:

V E N D I M **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË KLUBEVE DHE SHOQATAVE** **SPORTIVE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE NË** **KOMUNËN E PODUJEVËS**

Neni 1

Për financim publik të Klubeve dhe Shoqatave sportive, për realizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike datë 24.03.2026 dhe Rekomandimit të Komisionit vlerësues datë 02.06.2026, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **43.000 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/01-0031930/26
Podujevë, date: 02.06.2026



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031109/26 (i Komunës) dhe nr.127/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS PËR RINOVIMIN DHE** **NGJYROSJEN E OBJEKTEVE KOMUNALE**

Neni 1

Për menaxhimin e kontratës për renovimin dhe ngjyrosjen e objekteve komunale të përcaktuara sipas nr.prot.02-016/01-0031109/26 (i Komunës) dhe nr.127/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL “EKO Llapi” SH.A., që për lëndë ka: **“Rinovimin dhe ngjyrosjen e objekteve komunale”**, caktohet,

Ardian Emini - Menaxher i kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet
Të caktuarit
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-020/05-0031934/26
Podujevë, datë: 02.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031135/26 (i Komunës) dhe nr.124/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS PËR MIRËMBAJTEN E** **NDRIÇIMIT PUBLIK**

Neni 1

Për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kontratës për mirëmbajtjen e ndriçimit publik të përcaktuara sipas Kontratës nr.prot.02-016/01-0031135/26-(i Komunës) dhe nr.prot.124/III-(i Ndërmarrjes) të datës 28.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL "EKO Llapi" SH.A., që për lëndë ka: **"Mirëmbajtjen e Ndriçimit Publik në Komunën e Podujevës"**, caktohet,

Remzi Kodraliu - Menaxher i kontratës

Fidan Salihu- Mbikëqyrës i menaxhimit të kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet
Të caktuarëve
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-02605-0031936/26
Podujevë, datë: 02.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031124/26 (i Komunës) dhe nr.128/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS PËR MIRËMBAJTEN E** **HAPËSIRAVE PUBLIKE**

Neni 1

Për menaxhimin e kontratës për mirëmbajtjen e hapësirave publike të përcaktuara sipas Kontratës nr.prot.02-016/01-0031124/26 (i Komunës) dhe nr.128/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL "EKO Llapi" SH.A., që për lëndë ka: **"Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Podujevës"**, caktohet,

Remzi Kodraliu - Menaxher i kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet
Të caktuarit
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-016/05-0031937/26
Podujevë, datë: 02.06.2026



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031142/26 (i Komunës) dhe nr.126/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M

PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS PËR MIRËMBAJTJEN E SISTEMEVE TË NGROHJES KLIMATIZIMIT HIDROSANITARISË DHE KANALIZIMEVE NË OBJEKTE KOMUNALE

Neni 1

Për menaxhimin e kontratës për mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes klimatizimit hidrosanitarisë dhe kanalizimeve në objekte komunale të përcaktuara sipas nr.prot.02-016/01-0031142/26 (i Komunës) dhe nr.126/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL “EKO Llapi” SH.A., që për lëndë ka: **“Për mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes klimatizimit hidrosanitarisë dhe kanalizimeve në objekte komunale”**, caktohet,

Naime Ajeti – Menaxhere e kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet
Të caktuarës
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-020/05-0031959/26
Podujevë, datë: 02.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031136/26 (i Komunës) dhe nr.125/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS MBI KRYERJEN E** **SHËRBIMEVE / PUNËVE**

Neni 1

Për menaxhimin e kontratës mbi kryerjen e shërbimeve/punëve të përcaktuara sipas nr.prot.02-016/01-0031136/26 (i Komunës) dhe nr.125/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL "EKO Llapi" SH.A., që për lëndë ka: **"Mbi kryerjen e shërbimeve/ punëve"**, caktohet,

Blerim Vllasa - Menaxher i kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet
Të caktuarit
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-020/05-0031940/26
Podujevë, datë: 02.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr.prot.02-016/01-0031150/26 (i Komunës) dhe nr.129/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS PËR MIRËMBAJTJEN E** **ELEKTRIKËS DHE IT NË OBJEKTE KOMUNALE**

Neni 1

Për menaxhimin e kontratës për mirëmbajtjen e elektrikes të përcaktuara sipas nr.prot.02-016/01-0031150/26 (i Komunës) dhe nr.129/III (i Ndërmarrjes) të datës 29.05.2026, të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL "EKO Llapi" SH.A., që për lëndë ka: "**Për mirëmbajtjen e elektrikes dhe IT në objekte komunale**", caktohet,

Fidan Restelica - Menaxher i kontratës

Neni 2

Punët dhe detyrat ushtrohen në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për punën e kryer informohet Zyra e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet
Të caktuarit
NPL EKO Llapi- SH.A
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-020/05-0031944/26
Podujevë, datë: 02.06.2026



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 16, 19 paragrafi 1.6, dhe nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 datë 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr.prot.10-334/07-0030856/26 të datës 28.05.2026, merr:

V E N D I M **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

Nora Turs Sh.P.K. Numri Unik Identifikues 810114893, me seli në fshatin Sfeçël-Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Subvencionimi sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet për shkak të pamundësisë së përballimit të shpenzimeve për mbajtjen e rregullt të linjës së transportit të udhëtarëve në relacionin Podujevë-Balloç-Herticë dhe anasjelltas si rezultat i numrit të vogël të udhëtarëve, dhe ka për qëllim mbështetjen financiare për mbajtjen e linjës së transportit të udhëtarëve në relacionin e cekur përfshirë edhe sigurimin e transportit të rregullt për nxënës që vijnë në mësimin në shkollat e qytetit.

Neni 3

Mjetet buxhetore sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe barten në llogarinë bankare të Nora Turs Sh.P.K.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

Nora Turs Sh.P.K (njoftohet përmes DPZHE)

QSHQ/Arkivit.

Nr.Prot. 02-400/01-0032967/26
Podujevë, datë, 04.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/01-0062888/25, të datës 29.09.2025, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe Parashikimet Buxhetore 2027-2028, në implementimin e projektit “Përkrahje me fidane të mjedrës dhe sistemit të ujitjes”, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc, të datës 04.06.2026, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-00016997/26, të datës 24.03.2026, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e gjashtëmbëdhjetë (16) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e mjedrës.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në ftesën publike nr.12-320/01-00016997/26, të datës 24.03.2026, për aplikim në projektin “Përkrahje me fidane të mjedrës dhe sistemit të ujitjes”, në shumë të përgjithshme njëzetmijë euro (20,000.00€) për gjashtëmbëdhjetë (16) fermerët përfitues përkatësisht në vlerën prej 1,250.00€ si vlerë e mbështetjes për një (1) fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: “Përkrahje me fidane të mjedrës dhe sistemit të ujitjes”, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/04-0033409/26
Podujevë, datë 05.06.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 05.06.2026, të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej tetë mijë e nëntëqind euro (8,900 €) ndihmë për pesëdhjetë e një (51) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin maj 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0033819/26
Podujevë, datë 09.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 71 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë merr:

V E N D I M

Neni 1

Emërohet Grupi punues për konsultime publike i caktuar nga organi kompetent i Komunës në këtë përbërje;

Arbnorë Uka Osmani, Drejtoreshë e DBF-së	koordinatore
Lirie Hoti Rama, Drejtoreshë e DSHMS-së	anëtare
Avni Fetahu, Drejtor i DKA-së	anëtar
Mimozë Restelica, zyrtare për zhvillim DPZHE	anëtare
Liridona Rrahmani, zyrtare për informim dhe monitorim të mediave	anëtare
Valmire Rekaliu, zyrtare operatore DSHPMSH	anëtare
Remzi Kodraliu, zyrtar për regjistrim të adresave DPUMM	anëtar
Imer Hoti, udhëheqës i sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural DBPZHR	anëtar
Arianit Shaqiri, udhëheqës i sektorit të gjendjes civile DA	anëtar

Neni 2

Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt-propozimit i cili nënshtrohet procesit të konsultimit publik para aprovimit të tij.

Neni 3

Grupi punues do të punoj sipas Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit.
QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-020/04-0034036/26
Podujevë, datë, 09.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NËNKRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 60 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 paragrafi 5.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenin 63 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

z.Ardian Dervisholli, lirohet nga pozita Asistentit Administrativ në Zyrën e Nënkyetarit të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e asistentit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për arsye personale.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot.02-118/02-0034879/26
Podujevë, datë: 15.06.2016

Nënkyetari i Komunës
Fahri Restelica





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr.prot.02-400/04-0034330/26, të datës 11.06.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Elfe Kunushevci, nga fshati Lluga, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtimin të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 500€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorive përkatëse.
QSHQ/Arkivit.
*znj.Elfe Kunushevc*i, (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.Prot 02-400/01-0035300/26
Podujevë, datë; 17.06.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/01-0062888/25, të datës 29.09.2025, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe Parashikimet Buxhetore 2027-2028, në implementimin e projektit “Përkrahje me fidane të feferonave dhe somborakve dhe sistemit të ujitjes”, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc, të datës 15.06.2026, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0019998/26, të datës 02.04.2026, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë 20,000.00 €, për subvencionimin e njëzetë (20) fermerëve të Komunës së Podujevës me nga 1,000 € për një (1) fermer, në projektin “Përkrahje me fidane të feferonave dhe somborakve dhe sistem të ujitjes”.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në ftesën publike nr.12-320/01-0019998/26 të datës 02.04.2026, për aplikim në projektin “Përkrahje me fidane të feferonave dhe somborakve dhe sistem të ujitjes”, dhe atë për dhjetë (10) fermer përfitues me fidane të feferonave dhe sistem të ujitjes, si dhe dhjetë (10) fermer përfitues me fidane të somborakve dhe sistem të ujitjes.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: “Përkrahje me fidane të feferonave dhe somborakve dhe sistemit të ujitjes”, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/01-0035301/26
Podujevë, datë: 17.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj Arbnorë Uka Osmani, Drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të nënshkruaj vendimet për regjistrimin e hipotekave në kuadër të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, derisa znj.Saranda Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nr.prot. 02-016/01-0035875/26
Podujevë, datë: 18.06.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NËNKRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 5 dhe 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E ASISTENTIT ADMINISTRATIV NË ZYRËN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 1

z.Riard Qerimi, nga fshati Velikarekë, Komuna e Podujevës, me kualifikim fotograf-IAAP "Fan S.Noli", emërohet;

➤ **Asistent administrativ në Zyrën e Nënkrjetarit të Komunës së Podujevës**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative teknike të Nënkrjetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi.

Mandati i të emëruarit është në kohëzgjatje të mandatit të Nënkrjetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarit caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-M2/02-0036424/26
Podujevë, datë: 23.06.2026

Nënkrjetari i Komunës
Fabri Restelica





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, për angazhimin e stafit profesional/praktikantëve, në kuadër të institucioneve të Komunës së Podujevës nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës nr. prot. 02-016/01-0024916/26, datë 28.04.2026, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Komisioni për përzgjedhjen e stafit profesional për angazhim në punë praktike në institucionet e Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

Rilind Babatinca, kryesues
Bleona Musolli, anëtare
Arzie Potera, anëtare

Neni 2

Komisioni bën përzgjedhjen e stafit profesional të regjistruar si të papunë në Zyrën e Punësimit nga lista e gjerë e përgatitur dhe dërguar nga Zyra e cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:
Anëtarët e komisionit
Drejtorja e Administratës
Zyra e Personelit
Zyra e Punësimit-Podujevë
QSHQ/Arkivi*

Nr.prot.02-020/04-0037203/26
Podujevë, datë: 26.06.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

